



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 28 maj 2018
Nr. ref.: RK 1233/18

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI18/17

Parashtrues

Isuf Bajrami

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-II-14-0135, të 20 tetorit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Isuf Bajrami, me vendbanim në Velekincë, komuna e Gjilanit (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin [AC-I-15-0135] e 20 tetorit 2016 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejme: DHPGJS) për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP), me të cilin hodhi poshtë si të palejueshme kërkesën për revizion, të ushtruar kundër Aktgjykimit [AC-II-12-0070] të 27 marsit 2014 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, i cili konfirmonte Aktgjykimin [C. nr. 589/05] i 13 marsit 2007 i Gjykatës Komunale të Gjilanit.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], paragrafët 1 dhe 3, të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 1, të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], paragrafin 4, të nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], nenin 102 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafin 2, të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 të Kushtetutës, në nenin 22 [Procedimi i Kërkesës], nenin 47 [Kërkesat Individuale], nenin 48 [Saktësimi i Kërkesës] dhe nenin 49 [Afatet] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 24 shkurt 2017, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 20 mars 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Bekim Sejdiu.
7. Më 11 prill 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi DHPGJS-së.
8. Më 19 prill 2018, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 23 dhjetor 2004, parashtruesi i kërkesës ushtroi padi në DHPGJS për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejme: AKM) kundër të paditurave: Komuna e Gjilanit, KBI "Agrokultura" në Gjilan dhe Kooperativës Bujqësore në Zhegër, duke kërkuar vërtetimin e të drejtave pronësore të paluajtshmërive kontestuese, të cilat parashtruesi i kërkesës pretendon që i janë marrë paraardhësve të tij përgjatë viteve 1948-1995, gjatë procesit të reformës agrare.
10. Më 20 shtator 2005, DHPGJS përmes Aktvendimit [SCC-04-0209], ia referoi padinë Gjykatës Komunale të Gjilanit për të vendosur si gjykatë kompetente. Aktvendimi përkatës i DHPGJS-së kishte udhëzuar Gjykatën Komunale në Gjilan që në rast anekse kundër vendimit të kësaj Gjykate, kompetente do të ishte DHPGJS-ja.
11. Më 13 mars 2007, Gjykata Komunale në Gjilan përmes Aktgjykimit [C. nr. 589/05], e refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës. Arsyetimi i Aktgjykimit ishte bazuar, ndër të tjera, në të gjeturat e ekspertit të gjeodezisë dhe në faktin se parashtruesi i kërkesës "*nuk kishte dorëzuar prova bindëse nëse paluajtshmëritë kontestuese ishin konfiskuar, shpronësuar apo nacionalizuar*".
12. Në Aktgjykimin e saj, megjithatë, Gjykata Komunale në Gjilan, kishte këshilluar palët në kundërshtim me udhëzimet e dhëna nga DHPGJS në Aktvendimin [SCC-04-0209] të 29 shtatorit 2017, duke udhëzuar që aneksat kundër Aktgjykimit [C. nr. 589/05] të 13 marsit 2007, do të duhej të bëhen në Gjykatën e Qarkut në Gjilan. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës kishte ushtruar anekse edhe në Gjykatën e Qarkut në Gjilan edhe në DHPGJS. Aneksen e parë, parashtruesi i kërkesës e kishte bërë më 23 gusht 2007, ndërsa të dytën me 11 tetor 2007.
13. Më 26 tetor 2007, Gjykata e Qarkut në Gjilan përmes Aktvendimit [Ac. nr. 349/07], aprovoi aneksen e parashtruesit të kërkesës dhe prishi Aktgjykimin [C. nr. 589/05] të Gjykatës Komunale të Gjilanit dhe lëndën ia ktheu të njëjtës për rishqyrtim. Aktvendimin e saj, Gjykata e Qarkut në Gjilan e arsyetoi mbi bazën e shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
14. Më 21 dhjetor 2007, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë në DHPGJS, për lëshimin e Urdhrit Paraprak Gjyqësor (masës së përkohshme) për të parandaluar shitjen e paluajtshmërive kontestuese nga ana e të paditurave, deri në gjykimin përfundimtar të çështjes.
15. Më 31 korrik 2008, Kolegji i Apelit të DHPGJS-së, përmes Aktvendimit [SCA-07-0057] pezulloi përkohësisht procedurën. Ndërsa, më 24 shtator 2009, pas kërkesës për vazhdimin e procedurës të bërë nga parashtruesi i kërkesës, DHPGJS shfuqizoi Aktvendimin [SCA-07-0057] e 31 korrikut 2008 për pezullimin e procedurës së lëndës, duke u dhënë të paditurave një afat kohor prej 1 (një) muaji për dorëzimin e përgjigjeve të tyre në anekse.

16. Më 27 mars 2014, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së përmes Aktgjykimit [AC-II-12-0070]: 1) shpalli të pavlefshëm Aktvendimin [Ac. nr. 349/07] e 26 tetorit 2007 të Gjykatës së Qarkut në Gjilan; 2) deklaroi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës; dhe 3) konfirmoi Aktgjykimin [C. nr. 589/05] e 13 marsit 2007 të Gjykatës Komunale në Gjilan.
17. Më 28 prill 2014, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për revizion në DHPGJS në lidhje me Aktgjykimin [AC-II-12-0070] e 27 marsit 2014 të Kolegjit të Apelit, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
18. Më 20 tetor 2016, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së përmes Aktvendimit [AC-II-14-0135], hodhi poshtë si të palejueshëm kërkesën për revizion, duke arsyetuar se ky mjet juridik nuk ishte i lejuar me Ligjin nr. 04/L-033 për DHPGJS-së.
19. Rrjedhimisht, Kolegji i Apelit konkludoi që lënda ishte vendosur me Aktgjykimin [AC-II-12-0070] e 27 marsit 2014 dhe, duke marrë parasysh që Ligji nr. 04/L-033 për DHPGJS-në nuk përcakton asnjë mjet tjetër juridik për apelimin e këtij Aktgjykimi, ai është përfundimtar dhe i plotfuqishëm.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon që me Aktvendimin [AC-I-14-0135] e 25 tetorit 2016 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, përmes të cilit kërkesa e tij për revizion është shpallur e palejueshme, i janë shkelur të drejtat e tij në pronë të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1, të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon që përmes këtij aktvendimi i është shkaktuar dëm i pariparueshëm në kundërshtim me nenin 116.2 të Kushtetutës.
21. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, shkelje të Ligjit kundër Diskriminimit nr. 2004/3 të Republikës së Kosovës dhe shkelje të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/18 të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2008/27.
22. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon që Aktgjykimi [C. nr. 589/05] i 13 marsit 2017 i Gjykatës Komunale në Gjilan, është nxjerrë në shkelje të të drejtave të tij sepse është në kundërshtim me nenet 354, 355 dhe 356 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.
23. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të ndryshoj Aktvendimin [AC-I-140135] e 20 tetorit 2016 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, Aktgjykimin [AC-II-12-0070] e 27 marsit 2014 të DHPGJS-së dhe Aktgjykimin [P. nr. 589/05] e 13 marsit 2007 të Gjykatës Komunale në Gjilan, dhe ta kthej lëndën e tij në rivendosje.

Pranueshmëria e kërkesës

24. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të përcaktuara me Rregullore të punës.
25. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

26. Gjykata gjithashtu vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç specifikohet më tej në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale] dhe 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 i Ligjit
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48 i Ligjit
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

27. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [AC-II-14-0135] e 20 tetorit 2016 të DHPGJS-së, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit.
28. Megjithatë, Gjykata shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e përcaktuara me nenin 49 [Afatet] të Ligjit dhe rregullin 36 [Kriteret e pranueshmërisë],

respektivisht paragrafin (1) (c) të Rregullores së punës. Ato përcaktojnë si në vijim:

Neni 49 i Ligjit
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

Rregulli 36 i Rregullores së punës
[Kriteret e Pranueshmërisë]

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

c) kërkesa parashtrohet brenda 4 (katër) muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi; ose

[...].”

29. Në vlerësimin nëse janë përmbushur kriteret e nenit 49 të Ligjit në lidhje me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse kriteri për afatin 4 (katër) mujor, i përcaktuar me Ligj është respektuar në raport me “vendimin përfundimtar” të nxjerrë si rezultat i “mjetit juridik efektiv”, siç kërkohet me kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në Rregulloren e punës.
30. Përkatësisht, në vlerësimin nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, Gjykata duhet të vlerësojë, nëse vendimi i kontestuar, përkatësisht Aktvendimi i [AC-II-14-0135] i 20 tetorit 2016 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, është nxjerrë si rezultat i mjetit juridik efektiv, respektivisht, nëse kërkesa për revizion e ushtruar kundër Aktgjykimit [AC-II-12-0070] të 27 marsit 2016 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, ishte mjet juridik i lejueshëm i përcaktuar me ligj.
31. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet nenit 10 të Ligjit nr. 04/L-033 të DHPGJS-së, i cili përcakton:

[...]

“14. Të gjitha aktgjykimet dhe aktvendimet e Kolegjit të Apelit janë të prera dhe nuk i nënshtrohen asnjë apeli tjetër.

15. Asnjë dispozitë e këtij ligji nuk do të interpretohet ose zbatohet për të kufizuar ose për të tentuar për të kufizuar të drejtën kushtetuese të çdo personi për të paraqitur kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, në pajtim me ligjin dhe rregullat procedurale për një kërkesë të këtillë, për shqyrtimin e kushtetutshmërisë të cilitdo vendim ose aktgjykim të lëshuar nga Dhoma e Posaçme ose cilado gjykate tjetër.”

[...]

32. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, hodhi poshtë, si të palejueshme, kërkesën e parashtruesit të kërkesës për revizion, duke iu referuar në mënyrë specifike Ligjit për DHPGJS-në, dhe referencave të lartshënuara, dhe arriti në konkluzion se:

“... në bazë të nenit 10, paragrafit 14 të Ligjit nr. 04/L-033 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, në çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të gjitha aktgjykimet dhe aktvendimet e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së janë të prera dhe nuk i nënshtrohen asnjë apeli tjetër.”

33. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se, përveç Gjykatës, ligji përkatës nuk mundëson asnjë mjet tjetër efektiv juridik për apelimin e vendimeve përfundimtare të Kolegjit të Apelit. Ky konstatim është konfirmuar edhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, në rastet: KI02/15, me parashtrues Qendra shoqërore, kulturore, sportive dhe ekonomike “Pallati i Rinisë”, Aktvendimi për papranueshmëri i 18 majit 2015, paragrafi 29 dhe KI120/17, me parashtrues *Haviz Rizahu*, Aktvendimi për papranueshmëri i 7 dhjetorit 2017, paragrafi 34, ku Gjykata, ndër të tjera, theksoi:

“[është tërësisht e qartë se vendimet e DHPGJS-së nuk mund të jenë objekt i asnjë lloj procedure të mëtutjeshme qoftë edhe gjyqësore, përveç objekt i trajtimit në Gjykatën Kushtetuese.”

34. Duke parashtruar kërkesë për revizion kundër të Aktgjykimit [AC-II-12-0070] të 27 marsit 2016 të Kolegjit të Apelit, parashtruesi i kërkesës në fakt ka shfrytëzuar një mjet juridik i cili nuk ka qenë i përcaktuar me Ligjin për DHPGJS-në. Një gjë e tillë është konfirmuar qartë edhe me Aktvendimin [AC-II-14-0135] e 20 tetorit 2016 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, të cilin parashtruesi i kërkesës e konteston në Gjykatë. Ky i fundit megjithatë nuk është vendim që ndërlihet me “mjetin e fundit efektiv juridik” siç është përcaktuar në rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës në lidhje me kërkesat e nenit 49 [Afatet] të Ligjit.
35. Andaj, Gjykata konsideron se “vendimi përfundimtar” (mjeti i fundit efektiv juridik), sipas kuptimit të rregullit 36 (1) (c) dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës, për rastin e parashtruesit të kërkesës në të vërtetë është Aktgjykimi [AC-II-12-0070] i 27 marsit 2014 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, i cili është përfundimtar dhe nga publikimi i të cilit kanë kaluar më tepër se dy vite. (Shih, *Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 46477/99, GJEDNJ, Vendim i 14 marsit 2002; shih gjithashtu Gjykata Kushtetuese, rasti KI120/17, me parashtrues *Hafiz Rizahu*, Aktvendimi për papranueshmëri i 7 dhjetorit 2017, paragrafi 36).
36. Gjykata gjithashtu thekson që një qëndrim i tillë është në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, Gjykata interpreton të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë. Në lidhje me rastin konkret, GJEDNJ ka përcaktuar se veprimet e parashtruesve të kërkesave nuk mund të arsyetohen nëse ata janë përpjekur që të ushtrojnë mjete juridike pranë institucioneve a gjykatave të cilat, sipas ligjit, nuk kanë kompetencë që të

- ofrojnë mbrojtje të drejtave për të cilat ata ankohen. (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, *Fernie kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 14881/04, Vendim i 5 janarit 2006).
37. Gjykata rikujton po ashtu se parashtruesit e kërkesave duhet t'i shterojnë të gjitha mjetet juridike të cilat pritet të jenë, ndër të tjera, efektive. Vetëm mjetet efektive mund të merren parasysh nga Gjykata, pasi parashtruesit e kërkesave, nuk mund të zgjatin afatet kohore strikte të parapara me Ligj dhe Rregullore të punës, duke u përpjekur të përdorin mjete juridike në institucionet të cilat nuk kanë kompetencë që të ofrojnë mbrojtje të drejtave për të cilat ankohet parashtruesi i kërkesës. (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, *Fernie kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 14881/04, Vendim i janarit 2006; shih gjithashtu Gjykata Kushtetuese, rastin KI120/17, me parashtrues *Hafiz Rizahu*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 7 dhjetorit 2017, paragrafi 31).
 38. Për më tepër, Gjykata thekson se, pas pranimit të Aktgjykimit [AC-II-12-0070] të 27 marsit 2016 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, asgjë nuk e ka ndaluar parashtruesin e kërkesës që t'i drejtohet Gjykatës me kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit në fjalë. Megjithatë, ai nuk e ka bërë këtë, dhe duke shfrytëzuar një mjet juridik të palejuar me ligj, dhe rrjedhimisht joefektiv, ai ka humbur afatin prej 4 (katër) muajsh, për t'iu drejtuar me kërkesë Gjykatës. (shih, Gjykata Kushtetuese, rasti KI120/17, parashtrues *Hafiz Rizahu*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 7 dhjetorit 2017, paragrafi 35).
 39. Afati fillon të llogaritet nga vendimi i plotfuqishëm, si rezultat i shterjes së mjeteve adekuate dhe efektive për të siguruar korigjimin e çështjes, që është objekt i ankesës. (shih, *Norkin kundër Ruisë*, Kërkesa 21056/11, GJEDNJ, Vendimi i 5 shkurtit 2013 dhe shih gjithashtu *Moya Alvarez kundër Spanjës*, Nr. 44677/98, GJEDNJ, Vendimi i 23 nëntorit 1999).
 40. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe sipas rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar që rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe se vendimet e mëparshme nuk janë vazhdimisht të hapura për t'i kontestuar. (Shih, rastin *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa nr. 23274/04, GJEDNJ, Aktvendimi i 25 gushtit 2005; shih gjithashtu Gjykata Kushtetuese, rasti KI140/13, me parashtrues *Ramadan Cakiqi*, Aktvendimi për papranueshmëri i 17 marsit 2014, paragrafi 24, dhe rasti KI120/17, parashtrues *Hafiz Rizahu*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 7 dhjetorit 2017, paragrafi 39).
 41. Si përfundim, nga arsyet e shtjelluara si më sipër, Gjykata konkludon se kërkesa nuk është dorëzuar brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës dhe rrjedhimisht, Gjykata nuk mund të shqyrtoj meritat e rastit, përkatësisht, pretendimet për shkelje kushtetuese të parashtruesit të kërkesës.
 42. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si e paafatshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 20 dhe 49 të Ligjit dhe të rregullave 36 (1) (c) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 19 prill 2018, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani




Arta Rama-Hajrizi